

Në bazë të nenit 38 paragrafi 1 pika 1 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale (“Fletorja Zyrtare e MZ”, nr. 2/18, 34/19, 38/20, 50/22, 84/22), nenit 187 të Statutit të Komunës së Ulqinit (Fletorja Zyrtare e MZ – dispozitat e Komunës, nr. 49/19) dhe nenit 1 dhe 3 të Vendimit për qasje në ndryshimet dhe plotësimet e Statutit të Komunës së Ulqinit (Fletorja Zyrtare e MZ – dispozitat e Komunës, nr. 39/22), Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më _____2023 solli

VENDIMIN

MBI NDRYSHIMET DHE PLOTËSIMET E STATUTIT TË KOMUNËS SË ULQINIT

Neni 1

Në Statutin e Komunës së Ulqinit (Fletorja Zyrtare e MZ – dispozitat e Komunës numër 48/19) neni 7 paragrafi 3 ndryshon si në vijim:

„Flamuri i Komunës është i bardhë me stemën e vendosur në qendër gjeometrike të fushës bazë. Raporti i gjatësisë me gjerësinë është dy me një.”



Stema e Komunës së Ulqinit



Flamuri i Komunës së Ulqinit

Neni 2

Pas nenit 19 shtohet neni i ri 19a si më poshtë:

“Pakicat etnike kanë të drejtë të themelojnë institucion edukativo-arsimor.

Financimi i institucionit nga paragrafi 1 i këtij neni është obligim i Komunës së Ulqinit.”

Neni 3

Nenit 49 i shtohen tre paragrafë të rinj, si në vijim:

“Zgjedhjet për Kuvend i shpall Kryetari i Malit të Zi.

Zgjedhjet nga paragrafi 3 i këtij neni mbahen jo më vonë se pesëmbëdhjetë ditë para skadimit të mandatit të Kuvendit.

Nga dita e shpalljes deri në ditën e mbajtjes së zgjedhjeve mund të kalojë jo më pak se 60 dhe jo më shumë se 100 ditë.”

Neni 4

Në nenin 51 pika 3, pas fjalëve: "këshilltari më i vjetër", shtohen fjalët: “të cilin e ndihmon këshilltari më i ri.”

Pas paragrafit 3 shtohet paragrafi i ri, si vijon: “Në rast të pengimit ose ndërprerjes së mbledhjes nga ana e kryesuesit, për vazhdimin dhe kryesuesin e mbledhjes vendosin këshilltarët me shumicë të thjeshtë votash.”

“Në rast të ndërprerjes së mbledhjes, këshilltarët, me shumicë të thjeshtë, vendosin për vazhdimin e saj.”

Neni 5

Neni 58 ndryshon si më poshtë:

Punët e Kuvendit

Kuvendi:

- 1) sjell Statutin e Komunës;
- 2) sjell dispozita dhe akte të tjera të përgjithshme;
- 3) sjell Planin strategjik për zhvillimin e Komunës;
- 4) sjell plane dhe programe zhvillimore për fusha të veçanta;
- 5) sjell projekte urbanistike;
- 6) sjell programin e rregullimit të hapësirës, gjegjësisht planin e pajisjes komunale;
- 7) sjell programin e mbrojtjes dhe ruajtjes së zonës natyrore dhe kulturo-historike për lokalitetet arkeologjike të Qytetit të Vjetër - Kalaja, Ulqinit të Vjetër afër Krruçit, lokalitetit arkeologjik të Shasit, lokalitetit të Qerretit dhe lokalitetit të Villa romana rustica Krruç.
- 8) sjell Buxhetin dhe llogarinë përfundimtare të Buxhetit;
- 9) vendos dhe përcakton tatimet komunale, taksat, kompensimet dhe të hyrat e tjera vetanake;
- 10) disponon me pasuri të paluajtshme, përveç rasteve të tjetërsimit të të drejtave pronësore/pasurore mbi pasurinë e paluajtshme me ujdi të drejtpërdrejtë, të përcaktuara me ligj me të cilin është e rregulluar prona shtetërore;
- 11) përcakton kushtet për themelimin e bashkësive lokale dhe jep pëlqimin për vendimet mbi themelimin;
- 12) shpall referendum për territorin e komunës ose për një pjesë të territorit;
- 13) vendos për iniciativën qytetare;
- 14) vendos për shpalljen e vetëkontributeve për territorin e Komunës;
- 15) themelon shërbime publike;

- 16) sjell aktet e themelimit (jep pëlqimin për Statut dhe akte të tjera) për themelimin e subjektit juridik që kryen punë me interes publik;
- 17) vendos për huazimin dhe dhënien e garancive, në pajtim me ligjin;
- 18) jep pëlqimin për marrjen e borxheve të shërbimeve publike;
- 19) bënë konfirmimin e mandatit të këshilltarëve dhe vendos për të drejtat e këshilltarëve;
- 20) sjell vendim për shkurtimin e mandatit të Kuvendit;
- 21) zgjedh dhe shkarkon kryetarin e Kuvendit, kryetarin e Komunës dhe nënkryetarin e Kuvendit;
- 22) jep pëlqim për vendimin për emërimin dhe shkarkimin e nënkryetarit/ëve të Komunës;
- 23) emëron sekretarin e Kuvendit me propozim të kryetarit të Kuvendit;
- 24) emëron anëtarët e trupave punuese të Kuvendit;
- 25) emëron dhe shkarkon anëtarët e organeve drejtuese të shërbimeve publike;
- 26) shqyrton dhe miraton Raportin e punës së kryetarit të Komunës dhe organeve të administratës lokale;
- 27) shqyrton Raportin për punën e shërbimeve publike të themeluara nga Komuna;
- 28) shqyrton Raportin për zbatimin e rekomandimeve të Institucionit Shtetror të Auditit;
- 29) sjell Rregulloren për punën e vet;
- 30) sjell Kodin etik;
- 31) sjell vendim për pagat e funksionarëve lokal dhe personave që i emëron Kuvendi;
- 32) sjell vendim për pagat e zyrtarëve dhe nëpunësve lokal;
- 33) jep interpretim autentik të dispozitave që sjell;
- 34) formon trupa punuese të përhershëm dhe të përkohshëm për t'i shqyrtuar çështjet nga kompetencat e veta;
- 35) rregullon dhe siguron kryerjen e veprimtarive komunale dhe zhvillimin e tyre, rregullon kushtet dhe mënyrën e organizimit të punës për kryerjen e shërbimeve komunale dhe vendos për besimin e kryerjes së veprimtarive komunale;
- 36) përcakton kushtet e përgjithshme për rregullimin e vendbanimeve në territorin e komunës, shfrytëzimin e hapësirave publike, hapësirave të tjera, po ashtu dhe mënyrën e shfrytëzimit të hapësirave të parkimit;
- 37) përcakton emërtimet e zonave, vendbanimeve, rrugëve dhe shesheve si dhe kufijtë e tyre;
- 38) sjell vendim për vendbanimet me ndarjen territoriale të komunës;
- 39) përcakton kushtet dhe mënyrën e dhënies në shfrytëzim të përkohshëm të tokës ndërtimore dhe sjell programin për shfrytëzimin e përkohshëm të tokës ndërtimore;
- 40) përcakton kushtet dhe mënyrën e ndërtimit dhe vendosjes së objekteve të përkohshme;
- 41) sjell programin vjetor për fitimin e patundshmërive për nevojat e Komunës;
- 42) cakton orarin e punës së objekteve hoteliere, tregtare dhe artizanale dhe përcakton zonat në të cilat mund të kryhet një veprimtari e caktuar në përputhje me ligjin;
- 43) konstaton mirënjohjet publike të Komunës dhe rregullon mënyrën dhe procedurën e dhënies së mirënjohjeve publike;
- 44) sjell vendim për emetimin e letrave me vlerë;
- 45) sjell vendim për efikasitetin energjetik dhe prodhimin e burimeve alternative të energjisë elektrike;
- 46) formon shërbimin profesional për punët e Kuvendit;
- 47) vendos për numrin e këshilltarëve;
- 48) sjell vendim për marrjen, përdorimin, mbajtjen dhe shkatërrimin e vulave;

- 49) si rregull, jep mendim për ligjet dhe dispozitat e tjera me të cilat rregullohen çështjet me interes për vetëqeverisjen lokale;
- 50) vendos për bashkëpunim dhe asociim me bashkësitë lokale dhe asociacionet e shteteve të tjera;
- 51) vendos për themelimin e bashkësisë ndërkomunale;
- 52) vendos për themelimin e asociacionit të komunave për territorin e Malit të Zi;
- 53) sjell Planin e mbrojtjes nga zjarri;
- 54) parashikon kundërvajtje për shkelje të dispozitave të komunës;
- 55) vendos për kompensimin e punës së këshilltarëve;
- 56) sjell programin për ngritjen e përmendoreve me rëndësi lokale;
- 57) sjell kode etike për institucionet e tjera;
- 58) sjell vendim për themelimin e Këshillit për zhvillimin dhe mbrojtjen e vetëqeverisjes lokale;
- 59) kryen edhe punë të tjera të përcaktuara me ligj dhe me Statut.”

Neni 6

Neni 59, paragrafi 1 ndryshon si më poshtë:

Forumet Parlamentare janë:

1. Forumi për propozimin e emrave të vendbanimeve, rrugëve, shesheve dhe institucioneve;
2. Forumi për mbrojtjen e mjedisit, trashëgimisë kulturore materiale dhe jomateriale;
3. Forumi për parashtrësia, ankesat dhe të drejtat e personave me invaliditet;
4. Forumi për barazi gjinore dhe të drejtat e pakicave.

Neni 7

Neni 110 ndryshohet si vijon:

Punët e Kryetarit të Komunës

Kryetari i Komunës:

- 1) prezanton dhe përfaqëson Komunën;
- 2) propozon dispozita dhe akte të tjera, të cilët i miraton Kuvendi;
- 3) kujdeset dhe është përgjegjës për zbatimin e ligjeve, dispozitave të tjera dhe akteve të përgjithshme, planit strategjik për zhvillimin e komunës dhe planeve dhe programeve të tjera zhvillimore, si dhe për zbatimin e dokumenteve strategjike me rëndësi shtetërore;
- 4) kujdeset dhe është përgjegjës për zbatimin e punëve të deleguara dhe të besuara;
- 5) paraqet raportin mbi gjendjen e pasurisë së Komunës;
- 6) vendos për tjetërsimin e menjëhershëm të të drejtave pronësore mbi sendet e paluajtshme me marrëveshje të drejtpërdrejtë, në përputhje me ligjin që rregullon pronën shtetërore;
- 7) përcakton organizimin dhe mënyrën e punës së administratës lokale, me marrjen e mendimit të kryeadministratorit;
- 8) emëron dhe shkarkon nënkryetarin e Komunës, me pëlqimin e Kuvendit;
- 9) emëron dhe shkarkon kryeadministratorin, drejtuesit e organeve të administratës lokale dhe shërbimeve të veçanta nga neni 122 i këtij Statuti;
- 10) emëron dhe shkarkon kryearkitektin e qytetit;
- 11) emëron dhe shkarkon menaxherin;

- 12) i paraqet Kuvendit raportin vjetor për punën e tij dhe të organeve të administratës dhe shërbimeve lokale nga neni 122 i këtij Statuti deri më 31 mars të vitit aktual për vitin e kaluar;
- 13) drejton dhe harmonizon punën e organeve dhe shërbimeve të administratës lokale nga neni 122 i këtij Statuti dhe shërbimeve publike, me qëllim që të kryejnë në mënyrë sa më efikase funksionet e tyre dhe të ofrojnë shërbime publike më cilësore, për të cilat nxjerr aktet përkatëse;
- 14) jep pëlqimin për aktin për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e organeve dhe shërbimeve të administratës lokale nga neni 122 i këtij Statuti dhe shërbimeve publike;
- 15) ushtron mbikëqyrjen administrative mbi punën e organeve dhe shërbimeve të administratës lokale nga neni 122 i këtij Statuti dhe shërbimeve publike;
- 16) sjell akte sipas kompetencave të veta në zbatimin e punëve të deleguara dhe të besuara, nëse me dispozita të veçanta nuk është përcaktuar ndryshe;
- 17) është përgjegjës për zbatimin e vendimeve dhe akteve të tjera që i nxjerr Kuvendi dhe sjell akte për zbatimin e tyre;
- 18) sjell akte që sigurojnë zbatimin e buxhetit të Komunës;
- 19) sjell Planin kadrovik;
- 20) sjell Planin e integritetit;
- 21) sjell planin vjetor për trajnimin e zyrtarëve dhe nëpunësve lokalë;
- 22) disponon me mjetet e rezervës buxhetore rrjedhëse në pajtim me vendimin e Kuvendit;
- 23) zgjidh konfliktet e kompetencave ndërmjet organeve të qeverisjes lokale, shërbimeve publike dhe personave juridikë, të cilëve me vendim të Kuvendit u është ngarkuar kryerja e detyrave të caktuara;
- 24) vendos për përjashtimin e drejtuesve të organeve dhe të kryeadministratorit;
- 25) jep mendim për propozim-vendimet dhe aktet e tjera që i parashtrohen Kuvendit nga propozuesit e tjerë;
- 26) mbikëqyrë ligjshmërinë dhe përshtatshmërinë e punës së shërbimeve të veçanta;
- 27) formon sipas nevojës trupa profesionale për punë dhe detyra nga fushëveprimi i vet;
- 28) sjell akte të përkohshme nga kompetenca e Kuvendit, në pajtim me ligjin;
- 29) kryen ndarjen e hapësirave afariste që i shfrytëzojnë organet e komunës, cakton mënyrën e shfrytëzimit të mjeteve të transportit dhe vendos për blerjen dhe tjetërsimin e mjeteve të transportit dhe sendeve të tjera të luajtshme për nevojat e punës së organeve të Komunës.
- 30) kryen edhe punë të tjera të përcaktuara me ligj, Statut dhe akte të tjera të Komunës.”

Neni 8

Neni 118 i shtohet një paragraf si vijon:

“Nëse Kryetari i Komunës nuk zgjidhet brenda afatit sipas paragrafit 2 të këtij neni, me propozim të Qeverisë ose 1/3 së këshilltarëve, Kuvendi merr vendim për shkurtimin e mandatit të vet.”

Neni 9

Neni 119 i shtohet paragrafi 3, si më poshtë:

“Detyra të caktuara nga kompetencat e veta Kryetari ia beson Nënkryetarit të Komunës.”

Neni 10

Pas neni 137 shtohen tre nene të rinj si më poshtë:

"Konflikti i interesit

Neni 137a

Punët e Kryetarit të Komunës, Nënkyetarit dhe Kryeadministratorit janë të papajtueshme me funksionin e këshilltarit dhe anëtarësimin në organet drejtuese të shërbimeve publike të themeluara nga Komuna.

Punët e eprorëve të organeve të administratës lokale dhe drejtuesve të shërbimeve publike të themeluara nga Komuna janë të papajtueshme me funksionin e këshilltarit dhe anëtarësimin në organet drejtuese të shërbimeve publike të themeluara nga Komuna.

Personat nga paragrafi 1 i këtij neni nuk mund të angazhohen nga shërbimet publike, personat juridikë dhe fizikë për të kryer çfarëdo lloj pune që lidhet me punën e organeve të vetëqeverisjes lokale dhe është në funksion të realizimit të të drejtave dhe interesave të veta pranë organeve lokale.

Neni 137b

Konfliktin e kompetencave ndërmjet organeve të qeverisjes lokale e zgjidh kryeadministratori.

Konfliktin e kompetencave ndërmjet organeve të qeverisjes lokale, shërbimeve publike dhe personave juridikë, të cilëve u është besuar kryerja e detyrave të caktuara me vendim të Kuvendit i zgjidh Kryetari i Komunës.

Neni 137c

Për përjashtimin e zyrtarit të autorizuar të organit dhe kryeadministratorit vendos Kryetari i Komunës. Për përjashtimin e personit zyrtar, i cili zhvillon procedurën administrative dhe nxjerr akt administrativ në organin e qeverisjes lokale, shërbimin e posaçëm dhe shërbimin publik, vendos eprori i organit ose i shërbimit ose udhëheqësi i shërbimit publik.”

Neni 11

Neni 182, pas paragrafit 4 i shtohet një paragraf i ri, si vijon:

“Kur bëhet fjalë për ndryshime të rregullave të caktuara që kanë karakter të modifikimit teknike ose janë akte të brendshme apo akte individuale, nuk është e nevojshme që me propozim të dorëzohet analiza e ndikimit (RIA).

Neni 12

Harmonizimi i akteve të përgjithshme që dalin nga ky vendim do të bëhet brenda 90 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi.

Neni 13

Ky Vendim hyn në fuqi tetë ditë pas botimit në „Fletoren Zyrtare të Malit të Zi – dispozitat e komunës“.

Numër: 02-_____

Ulqin, më _____ 2023

KUVENDI I KOMUNËS SË ULQINIT

Kryetari

Ardijan Mavriq

Arsyetim

Baza ligjore për marrjen e vendimit në fjalë, që ka të bëjë me ndryshimet dhe plotësimet në Statut, gjendet në nenin 38 paragrafi 1 pika 1 e Ligjit për vetëqeverisjen lokale (“Fletorja Zyrtare e MZ, nr. 02/18 dhe 34/19), i cili parasheh që Kuvendi i Komunës sjell Statutin.

Po ashtu, në nenin 187 të Statutit të Komunës së Ulqinit (“Fletorja Zyrtare e MZ - dispozitat e komunës”, nr. 49/19), është paraparë që procedura për ndryshimin e Statutit të inicohet me propozim-vendim për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit.

Propozimi mund të bëhet nga të paktën 1/3 e këshilltarëve, kryetari i Komunës dhe së paku 5% e zgjedhësve të regjistruar në listën zgjedhore të komunës, sipas të dhënave për numrin e votuesve nga zgjedhjet e fundit.

Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më 29.07.2022 solli vendimin për nisjen e ndryshimeve dhe plotësimeve në Statutin e Komunës, i cili u botua në “Fl. Zyr. MZ – dispozitat e komunës”, nr. 39/22.

Kuvendi ka formuar edhe një grup punues me vendim të veçantë për përgatitjen e versionit punues të Draftit për ndryshimet dhe plotësimet të Statutit, në mënyrë që më pas këshilli për Statut dhe dispozita të konfirmojë propozimin për miratim.

Arsyet për ndryshimin e Statutit gjenden në faktet e mëposhtme:

- në Statutin ekzistues, stema dhe flamuri i Komunës përshkruhen në një nen të veçantë, por ato nuk janë paraqitur në versionin vizual të stemës dhe flamurit origjinal; me këtë ndryshim shfaqet versioni vizual i stemës dhe flamurit origjinal të Komunës së Ulqinit;
- detyrat e Kuvendit dhe të kryetarit në Statutin ekzistues janë kopjuar nga ligji; ndryshimet e propozuara rregullojnë më nga afër dhe më hollësisht punët e Kuvendit, Kryetarit të Komunës dhe detaje të tjera;
- me këto ndryshime ligjërisht janë rregulluar rastet e bllokimit të punës së Kuvendit me përcaktimin e afateve për zhbllokim në rast të marrjes së mandatit të Kuvendit, përkatësisht shkurtimit të mandatit;
- Statuti i Komunës së Ulqinit si normë të veçantë parasheh që komuna të ketë nënkryetar, por nuk është përcaktuar se çfarë detyrash kryen, në mënyrë që funksioni i nënkryetarit të mos jetë i përputhshëm me funksionin e këshilltarit të Kryetarit;
- me dispozitat e Ligjit për të drejtat dhe liritë e pakicave parashihet mundësia që popujt pakicë të mund të themelojnë institucione arsimore, e që janë të detyruar të financojnë veprimtaritë arsimore për institucionin në fjalë nga të ardhurat e tyre;
- me Statutin që është në fuqi nuk është elaboruar më saktë dhe më hollësisht institucioni i konfliktit të interesit të zyrtarëve komunalë, drejtuesve të organeve të administratës lokale, drejtorëve ekzekutivë të shërbimeve publike dhe udhëheqësve të tjerë komunalë.

Pas nenit 137 të Statutit u shtua një kapitull i veçantë.

Vendimi për ndryshime ka 13 nene, ndaj arsyet janë shtjelluar përmes tekstit të vendimit.

Për zbatimin e këtij vendimi nuk nevojiten mjete financiare, përveç mjeteve për botim dhe kompensimit për punën e grupit punues, si dhe shpenzimeve të printimit të tekstit të spastruar për aplikim më të lehtë.

Në lidhje me analizën e ndikimit (RIA), konsiderohet se nuk është e nevojshme bashkëngjitja e saj, sepse Statuti nuk zbatohet drejtpërdrejt tek qytetarët, por zbatohet nëpërmjet miratimit të vendimeve apo rregulloreve të veçanta që dalin nga Statuti.

GRUPI PUNUES